



KOMUNA E LIPJANIT



SHOQATA E TË DREJTAVE TË  
PACIENTËVE NË KOSOVË- PRAK

REPUBLIKA E KOSOVES  
KOMUNA LIPJAN  
REPUBLIKA KOSOVO  
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar me:	06.07.2022	
Priljeno:		
Nësia Jednica	Numri Shtoj	Shtojca Dodatak
01-660/03	-35326	

## MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

KOMUNA E LIPJANIT

DHE

SHOQATA E TË DREJTAVE TË PACIENTËVE NË KOSOVË

Palët në këtë memorandum:

**KOMUNA E LIPJANIT** me seli në adresën, Rr. Shqipëria nr:28, 14000 Lipjan, Republika e Kosovës, përfaqësuar nga Kryetari i Komunës z. Imri AHMETI.

*dhe*

**SHOQATA E TË DREJTAVE TË PACIENTËVE NË KOSOVË PRAK** me seli në adresë Rr. 11 Marsi, Lam 3B, nr. 2, 20 000 Prizren, Republika e Kosovës, përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv Z. Ruzhdi REXHA.

Palët në këtë memorandum dakordohen si në vijim:

## **Neni 1 Qëllimi**

- 1.1. Ky Memorandum ka për qëllim bashkëpunimin e Drejtorisë për Shëndetesi dhe Perkuajdesje Sociale ( në vazhdim nën akronimin DSHPS) dhe Shoqatës së të Drejtave të Pacientëve në Kosovë (në vazhdim nën akronimin PRAK ) në themelimin e Këshillit të Pacientëve në Komunën e Lipjanit.

## **Neni 2 Fusha e bashkëpunimit**

1. Palët dakordohen që të angazhohen për nevojat e veprimtarisë së tyre në këto çështje:
  - 1.1 PRAK do të përgatis dokumentacionin për themelimin dhe funksionalizimin e Këshillave të Pacientëve;
  - 1.2 PRAK do të ndihmoj në përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Pacientëve;
  - 1.3 PRAK do të organizoj trajnime për anëtarët e zgjedhur në Këshillin e Pacientëve;
  - 1.4 DSHPS do të miratoj dokumentacionin për themelimin dhe funksionalizimin e Këshillit të Pacientëve;
  - 1.5 DSHPS do të themeloj një komision të përbërë nga një përfaqësues i tyre, një nga QKMF dhe një nga shoqëria civile për përgatitjen, shpalljen dhe përzgjedhjen e anëtarëve të këshillit të Pacientëve.
  - 1.6 DSHPS do të shpallë thirrjen për anëtar të Këshillit të Pacientëve;
  - 1.7 DSHPS do të bëjë njohjen (përmes një vendimi) për Këshillin e Pacientëve;
  - 1.8 DSHPS, së bashku me QKMF sigurojnë një hapsirë pune për punën e Këshillit të Pacientëve;
  - 1.9 DSHPS, angazhohet për sigurimin e subvencioneve dhe donacioneve për Këshillin e Pacientëve për të ushtruar veprimtarinë e vet;
  - 1.10 DSHPS angazhohet për të punuar së bashku me këshillin e pacientëve për të identifikuar dhe eliminuar problemet që kanë pacientët për të marrë shërbime shëndetësore;

### Neni 3 Metodologjia e bashkëpunimit

1. Me qëllim të realizimit të bashkëpunimit të ndërsjellët, palët dakordohen që bashkëpunimin e përcaktuar në nenin 2 të këtij memorandumi ta realizojnë përmes:
  - 1.1 Takimeve të thirrura nga cilado palë në bazë të nevojës në mes të përfaqësuesve të DSHPS -së dhe përfaqësuesve të PRAK-ut;
  - 1.2 Punës së përbashkët në hartimin dhe miratimin e dokumentacionit për Këshillat e Pacientëve;
  - 1.3 Puna e përbashkët në përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Pacientëve;
  - 1.4 Puna e përbashkët në monitorimin e punës së Këshillit të Pacientëve;
  - 1.5 Puna e përbashkët në sigurimin e funksionalitetit të Këshillit të Pacientëve;
  - 1.6 Bashkëpunimi për nismat e përbashkëta për realizimin e aktiviteteve specifike në fushë veprimtarinë e palëve.
2. Për çfarëdo nevoje lidhur me praktikat e bashkëpunimit, palët në këtë memorandum do të bashkërendojnë veprimet e tyre me qëllim të arritjes së objektivave të shprehura në këtë memorandum.

### Neni 4 Mënyra e komunikimit

1. Palët dakordohen që për çdo çështje të kontaktojnë përmes zyrtarëve të autorizuar në mënyrë të drejtpërdrejtë. Palët do t'ia komunikojnë zyrtarët e tyre për komunikim përmes shkresës zyrtare të autorizuar nga organi kompetent i palës.
2. Komunikimi në mes të zyrtarëve të autorizuar do të realizohet, por nuk do të kufizohet, përmes takimeve të drejtpërdrejta si dhe përmes komunikimit formal përmes postës dhe komunikimit elektronik.
3. Adresat zyrtare të komunikimit janë:
  - 3.1 Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirqenje Sociale – z. Shkelzen Hajdini E-mail: [shkelzen.hajdini@assembly-kosova.org](mailto:shkelzen.hajdini@assembly-kosova.org), nr. tel. +383 44 173 512 .
  - 3.2 Shoqata e të drejtave të pacientëve në Kosovë – E-mail [info@prak-kosova.org](mailto:info@prak-kosova.org), nr. tel + 383 49 946 201.

### Neni 5 Kohëzgjatja e memorandumit

Ky memorandum lidhet për një periudhë 4 vjeqare me mundësi vazhdimi.

## Neni 6

Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin ose zbatimin e këtij memorandumi zgjidhet me mirëkuptim mes *Palëve*.

## Neni 7


### Hyrja në fuqi

1. Ky Memorandum i Bashkëpunimit hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.
2. Ky memorandum është lidhur në gjuhën shqipe dhe atë në 2 (dy) ekzemplar identik, nga 1 (një) për secilën palë.

Lipjan 06 / 07 / 2022

**Për Komunën e Lipjanit**

Z. Imri AHMETI



**Për PRAK**

Z. Ruzhdi Rexha

